

Draft PASAPORTA E TREGUESIT

Për matjen e treguesve të Strategjisë për Rregullim më të Mirë 2.0 (SRM) 2017-2021

Qëllimi i kësaj pasaporte të treguesve është të ofrojë një përshkrim të hollësishëm metodologjik të matjeve për të gjithë treguesit që janë përfshirë në **Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 2017-2021** të miratuar në dhjetor të vitit 2016 nga Qeveria e Kosovës.

Ky dokument shërben për mbështetjen e përkufizimit të treguesve për vlerësimin e progresit të bërë lidhur me objektivet specifike të prezantuar në SRRM. Kjo përfshin identifikimin e të dhënave të nevojshme për matjen e progresit, metodologjinë e përlogaritjes, të kuptuarit dhe interpretimin e saktë të të dhënave dhe informatave mbi performancën.

Dokumenti mbulon të gjithë treguesit e përfshirë në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2. në nivel të objektivave specifike. Korniza përfshin si treguesit cilësorë ashtu edhe ata sasiorë që mbulojnë secilin objektiv specifik me të paktën një tregues. Përshkrimi i hollësishëm metodologjik i matjeve ndjek të njëjtën strukturë sikurse strategjia e cila përfshin katër objektivet e përgjithshëm në vijim:

Objektivi i Përgjithshëm 1: Sistem rregullativ lehtësues

Objektivi i Përgjithshëm 2: Komunikimi efikas me publikun, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesit

Çdo tregues, siç është përcaktuar për Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2.0 2017-2021, përfshin elementet e paraqitura në vijim:

- Objektivin specifik korrespondues për secilin tregues;
- Përshkrimin e shkurtër të treguesit;
- Burimin e informatave (të dhënave) që shërben si bazë e matjes së treguesit;
- Institucionin përgjegjës për mbledhjen e të dhënave për matjen e treguesit, që përfshin ofrimin e informatave për qëllime të raportimit/monitorimit dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave;
- Shpeshhtësinë e publikimit të të dhënave (dhe/ose mbledhjes së të dhënave);
- Të dhënat që janë të nevojshme për të matur progresin në bazë të treguesit;
- Përshkrimin metodologjik të metodës së matjes, në mënyrë që të mundësohet kontrolli i jashtëm dhe të kuptuarit më të mirë se si vlerat e treguesve të caktuar janë zhvilluar;
- Vlerat bazë dhe të synuara (të përcaktuara në BRS-në e miratuar).

Një sërë treguesish, të cilët janë të përfshirë në BRS janë tregues SIGMA bazuar në Parimet për Administratë Publike. Metodologjia e zhvilluar për treguesit e tjerë ishte posaçërisht për nevojat e treguesit.

Informatat e përfshira në këtë Pasaportë të Treguesve janë zhvilluar nën udhëheqjen e Zyrës së Kryeministrit bazuar në informatat e ofruara nga institucionet përgjegjëse dhe formulimi i tyre është bërë në pajtim të plotë me të gjitha institucionet përgjegjëse dhe me mbështetjen e ekspertëve të OECD-së/SIGMA-së. Kjo pasaportë e treguesve është përditësuar në bazë të zotimeve të pasqyruara në Kontratën e Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike që ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor të vitit 2017.

TABELA E PËRMBAJTES

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1: Sistemi Rregullativ Lehtësues	4
Objektivi specifik 1.1: Reformat e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar për të rritur konkurrueshmërinë	4
Treguesi 1.1.1 Miratimi i koncept dokumentit për programin për zvogëlimin e barrës Administrative	4
Treguesi 1.1.2: Zhvillimi i kapaciteteve për MKS	6
Treguesi 1.1.3: Rritja e kapaciteteve të trajnimit për zbatimin e Modelit Standard të Kostos	8
Treguesi 1.1.4: Integrimi i MKS-së në hartimin e politikave	9
Objektivi Specifik 1.2. Prezantimi i Vlerësimit të Ndikimit	11
Treguesi 1.2.1 Rritja e kapaciteteve për zhvillimin e politikave në institucionet e QQ dhe ministritë e linjës.....	11
Treguesi 1.2.2 Rritja e kapaciteteve të trajnimit për Vlerësimin e Ndikimit.....	11
Treguesi 1.2.3: Përgatitja dhe miratimi i RRP për zëvendësimin e koncept dokumenteve me vlerësim të ndikimit	13
Treguesi 1.2.4: Zhvillimi i politikave do të bazohet më shumë në dëshmi dhe VN do të përdoret rregullisht nga ministritë e linjës	14
Objektivi Specifik 1.3: Të dhënat/statistikat e përmirësuara	16
Treguesi 1.3.1: të dhëna të standardizuara janë në dispozicion për llogaritjet e MKS	16
Treguesi 1.3.2: Baza e të dhënave të VN-së është zhvilluar	17
Objektivi Specifik 1.4: Vlerësimi	19
Treguesi 1.4.1: Vlerësimet realizohen në baza vjetore.....	19
Treguesi 1.4.2: Kapacitete të ngritura të trajnimit mbi vlerësimin.....	20
Treguesi 1.4.3: Ngritja e kapaciteteve për Vlerësim në institucionet QQ dhe ministritë e linjës.....	21
Treguesi 1.4.4: Krijimi i procesit për përdorimin e gjetjeve të vlerësimit për përmirësimin e legjislacionit ekzistues	23
OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 2: Komunikimi efikas publik, konsultimi publik dhe pjesëmarrja e palëve të interesit	25
Objektivi specifik 2.1: Përmirësimi i Komunikimit të Politikave	25
Treguesi 2.1.1: Hartimi i Planit të Veprimit për përmirësimin e komunikimit të politikave.....	25
Treguesi 2.1.2: Ngritja e Kapaciteteve të Trajnimit për Komunikim të Politikave	26
Treguesi 2.1.3: Zhvillimi i kapaciteteve për komunikim të politikave.....	26
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: përmirësimi i Konsultimit.....	28
treguesi 2.2.1: Ngritja e kapaciteteve të personelit për konsultime	30
TREGUESI 2.2.2: Niveli i përputhjes me Standardet Minimale për të gjitha vendimet relevante të qeverisë	32
Treguesi 2.2.3: Rritja e efektivitetit të konsultimit publik në hartimin e politikave dhe legjislacionit	34
OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3: Përmirësimi i planifikimit të punës	35
TREGUESI 2.3.1: Hartimi dhe miratimi i KD në PISHP	35

Treguesi 2.3.2: Zhvillimi i PISHP	36
Treguesi 2.3.3: Rritja e cilësisë së planifikimit të punës së qeverisë	37

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 1: SISTEMI RREGULLATIV LEHTËSUES

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1: REFORMAT E LEGJISLACIONIT EKZISTUES PRIMAR DHE SEKONNDAR PËR TË RRITUR KONKURRUESHMËRINË

TREGUESI 1.1.1 MIRATIMI I KONCEPT DOKUMENTIT PËR PROGRAMIN PËR ZVOGËLIMIN E BARRËS ADMINISTRATIVE

Titulli i Treguesit	1.1.1 MIRATIMI I KONCEPT DOKUMENTIT PËR PROGRAMIN E ZVOGËLIMIT TË BARRËS ADMINISTRATIVE		
Nën-objektivi përkatës	1.1. Reformat e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar për të rritur konkurrueshmërinë		
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi vlerëson nëse qeveria e ka miratuar Koncept Dokumentin mbi zbatimin e mundshëm të programit për zvogëlimin e barrës administrative. Koncept dokumenti do të ofrojë analizën e politikave lidhur me përfitimet dhe kostot e zbatimit të programit për zvogëlimin e barrës administrative. Kjo analizë do të përfshijë krahasimin e dizajneve të projekteve të mundshme, kërkesat kryesore lidhur me zvogëlimin e barrës administrative karshi caktut të përcaktuar, si dhe vlerësimin e buxhetit për secilin opsion të dizajnit të programeve të realizueshme..		
Burimi i të dhënave për monitorimit e treguesit të performancës	Vendimi i Qeverisë për miratimin e Koncept Dokumentit mbi Programin për Zvogëlimin e Barrës Administrative..		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë/ZKM		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Vendimi i Qeverisë në lidhje me miratimin e Koncept Dokumentit për Zvogëlimin e Barrës Administrative.		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Kontrollohet nëse vendimi për Koncept Dokumentin për Zvogëlimin e Barrës Administrative miratohet në/para vitit 2019 siç pasqyrohet në Strategjinë për Rregullim më të Mirë		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ekziston dizajn efektiv i programit për zvogëlimin e barrës administrative	
	Viti	2018	2021

Informatat mbi vlerat e synuara	Vlera e treguesit	Ky koncept dokument është në procedurë të hartimit	Koncept dokumenti për zvogëlimin e barrës administrative është miratuar
--	--------------------------	--	---

TREGUESI 1.1.2: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR MKS

Titulli i Treguesit	1.1.2 Zhvillimi i kapaciteteve për MKS
Nën-objektivi përkatës	1.1. Reformat e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar për të rritur konkurrueshmërinë
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi synon matjen e rritjes së kapaciteteve, përkatësisht përmes trajnimeve, në Zyrën e Kryeministrit dhe ministrive të linjës në mënyrë që të zbatojë Modelin Standard të Kostos (MKS) gjatë hartimit të politikave.
Burimi i të dhënave për monitorimet e treguesit të performancës	1) Listat e vijueshmërisë në trajnimet MKS 2) Raportet e trajnimit
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë (përgjegjës kryesor) me mbështetje të ofruar nga IKAP
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	<i>Çdo vit</i>
Të dhënat e nevojshme	1. Numri i personelit të trajnuar rreth MKS-së në ZKM dhe ministrinë e linjës 2. Numri i personelit që duhet trajnuar në ZKM dhe ministrinë e linjës
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke iu referuar numrit të stafit që është trajnuar për zbatimin e MKS-së kundrejt numrit të përgjithshëm të stafit të ZKM-së dhe ministrisë së linjës, për të cilët trajnimi mbi MKS-në është i rëndësishëm.</p> <p>Divizionet ministrore, të cilat janë të rëndësishme për zbatimin e MKS-së dhe parandalimin e barrëve administrative për kompanitë janë po ato divizione që janë përgjegjëse për legjislacionin që ndikon drejtpërdrejt në aktivitetet e biznesit dhe imponon Detyrime Informuese për kompanitë. Divizionet ministrore relevante me MKS-në janë të renditura në Shtojcën mbi numrat e trajnimit, që është e bashkangjitur në këtë Pasaportë të Treguesit.</p> <p>Për secilin divizion përkatës të politikës, duhet të trajnohet një person. Përveç kësaj, një anëtar i stafit nga Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave në ministrinë e linjës duhet të jetë i trajnuar. Zyrat në kuadër të ZKM-së, të cilat kanë rolin qendror koordinues dhe të sigurimit të cilësisë duhet të kenë të gjithë ose shumicën e stafit të trajnuar.</p>

	<p>Numri i përgjithshëm i stafit përkatës që duhet trajnuar mbi zbatimin e MKS-së është 183 zyrtarë.</p> <p>Formula për vlerësimin e progresit në bazë të këtij treguesi është si në vijim:</p> $\text{Trajnimi MKS \%} = \frac{\text{Numri i stafit që është trajnuar mbi MKS-në në QQ dhe ministritë e linjës}}{\text{Numri i stafit që duhet trajnuar në QQ dhe ministritë e linjës}} \times 100 = \frac{\text{Numri i stafit që është trajnuar mbi MKS-në në QQ dhe ministritë e linjës}}{\text{Numri i stafit që duhet trajnuar në QQ dhe ministritë e linjës}} \times 100$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ekziston asnjë trajnim MKS	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	20% e gjithë personelit relevant në ZKM dhe ministritë e linjës janë trajnuar	Kapacitetet janë zhvilluar plotësisht (90% e gjithë personelit relevant në ZKM dhe ministritë e linjës janë të trajnuar)

TREGUESI 1.1.3: RRRITJA E KAPACITETEVE TË TRAJNIMIT PËR ZBATIMIN E MODELIT STANDARD TË KOSTOS

Titulli i Treguesit	1.1.3 Rritja e kapaciteteve të trajnimit për zbatimin e Modelit Standard të Kostos		
Nën-objektivi përkatës	1.1. Reformat e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar për të rritur konkurrueshmërinë		
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi synon të masë nivelin e ngritjes së kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe të ministrive për zbatimin e Modelit të Kostos Standarde duke krijuar një grup të trajnerëve që do të mbajnë trajnime për këto fusha për personelin e identifikuar.		
Burimi i të dhënave për monitorimit e treguesit të performancës	Raportet e trajnimit		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë (përgjegjës kryesor) me mbështetje të ofruar nga IKAP		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Të dhënat që duhet të ofrohen për këtë tregues janë informatat mbi grupin e trajnerëve që janë të certifikuar të mbajnë trajnime mbi zbatimin e Modelit të Kostos Standarde.		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Duhet të ceket numri i trajnerëve që janë të certifikuar të mbajnë trajnime mbi zbatimin e Modelit të Kostos Standarde.		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	5	E pandryshuar në krahasim me cakun e vitit 2018

TREGUESI 1.1.4: INTEGRIMI I MKS-SË NË HARTIMIN E POLITIKAVE

Titulli i Treguesit	1.1.4 Integrimi i MKS-së në zhvillimin e politikave	
Nën-objektivi përkatës	1.1. Reformat e legjislacionit ekzistues primar dhe sekondar për të rritur konkurrueshmërinë	
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi mat parandalimin e barrës administrative përmes zbatimit të metodologjisë matëse të MKS. Ai do të masë numrin e koncept dokumenteve që përmbajnë një pjesë për barrën administrative me matjet e MKS-së të miratuara për çdo vit.	
Burimi i të dhënave për monitorimit e treguesit të performancës	Raporti vjetor i Qeverisë për Koncept Dokumentet e miratuara nga Qeveria	
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë	
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit	
Të dhënat e nevojshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i koncept dokumenteve të miratuar nga Qeveria që kanë një pjesë të barrës administrative me matje të MKS-së 2. Vlerësimi nëse një Koncept Dokument i miratuar është përkatës 3. Numri i përgjithshëm i Koncept Dokumenteve përkatëse të miratuara nga Qeveria 	
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke ndjekur dy hapa:</p> <p>Së pari, nga të gjitha koncept dokumentet që miratohen nga Qeveria brenda vitit raportues, përzgjidhet numri i koncept dokumenteve relevante. Një koncept dokument është relevant nëse adreson organizimin e aktiviteteve afariste përmes intervenimeve qeveritare dhe merret me detyrimet për informim të cilin duhet të e përmbushin bizneset.¹</p> <p>Së dyti, treguesi matet duke përlogaritur raportin e numrit të koncept dokumenteve të miratuara në Qeveri që përmbajnë pjesën e barrës administrative me matje të MKS-së dhe duke krahasuar numrin e përgjithshëm të koncept dokumenteve relevante të miratuara nga Qeveria në vit.</p> $\text{Matja KD-MKS \%} = \frac{\text{Numri i KD me matje MKS}}{\text{Numri i KD përkatëse}} \times 10 \frac{\text{Numri i KD me matje MKS}}{\text{Numri i KD përkatëse}} \times 100$	
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016

¹ Koncept dokumentet që nuk konsiderohen relevante janë ato që rregullojnë vetëm aktivitetet qeveritare dhe nuk kanë ndikim mbi atë se si bizneset duhet t'i organizojnë aktivitetet e tyre; shembuj të temave që adresojnë koncept dokumente të tilla janë (1) themelimi, bashkimi dhe/ose shpërbërja e organizatave të tilla si agjencitë qeveritare; (2) organizimi i proceseve të punës së administratës; dhe (3) të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve.

	Vlera bazë	-MKS që nuk është pjesë e hartimit të politikave	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	MKS e përfshirë në udhëzimet për zhvillimin e politikave (30% e KD-ve relevante përmbajnë pjesën për barrën administrative me matje MKS)	- MKS e përfshirë në udhëzimet për zhvillimin e politikave (100% e KD-ve relevante përmbajnë pjesën për barrën administrative me matje MKS)

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2. PREZANTIMI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

TREGUESI 1.2.1 RRIJJA E KAPACITETEVE PËR ZHVILLIMIN E POLITIKAVE NË INSTITUCIONET E QQ DHE MINISTRITË E LINJËS

Titulli i Treguesit	1.2.1 Rritja e kapaciteteve për zhvillimin e politikave në institucionet e QQ dhe ministrinë e linjës
Nën-objektivi përkatës	1.2. Vlerësimi i ndikimit
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi synon të masë nivelin e rritjes së kapaciteteve për hartimin e politikave në zyrën e Kryeministrit dhe ministrinë e linjës, kryesisht përmes trajnimeve mbi hartimin e politikave për stafin përkatës.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	1) Listat e vijueshmërisë për trajnimet e hartimit të politikave 2) Raportet e trajnimit
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë (përgjegjës kryesor) me mbështetje të ofruar nga IKAP
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Të dhënat e nevojshme	1. Numri i personelit të trajnuar për zhvillimin e politikave në ZKM dhe ministrinë e linjës 2. Numri i personelit që do të trajnohet për zhvillimin e politikave në ZKM dhe ministrinë e linjës
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke përllogaritur numrin e personelit të trajnuar për zhvillimin e politikave (zhvillimi i koncept dokumenteve dhe vlerësimeve të ndikimit) në raport me numrin e përgjithshëm të personelit të ZKM-së dhe ministrive të linjës që janë relevante për t'u trajnuar në fushën e zhvillimit të politikave.</p> <p>Të gjitha departamentet dhe divizionet ministrore që hartojnë politika dhe legjislacion janë përkatëse, ashtu siç janë departamentet/divizionet që plotësojnë një koordinim të funksionit të shqyrtimit të cilësisë. Numrat e stafit, për të cilët trajnimi i hartimit të politikave është përkatës, janë paraqitur në Shtojcën mbi numrat e trajnimit e cila është e bashkangjitur në këtë Pasaportë të Treguesit.</p> <p>Në nivel të çdo departamenti ministror dhe të çdo divizioni ministror, një person duhet të jetë i trajnuar. Përveç kësaj, stafi në Departamentet Ligjore; Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave; Divizionet e Buxhetit; dhe divizionet e Komunikimit në ministrinë e linjës që janë të përfshira në hartimin e politikave duhet të trajnohen. Zyrat në kuadër të ZKM-së, të cilat kanë rolin qendror koordinues dhe të sigurimit të cilësisë duhet të kenë të gjithë ose shumicën e stafit të trajnuar.</p> <p>Numri i përgjithshëm i stafit përkatës që duhet trajnuar mbi hartimin e politikave është 545 zyrtarë.</p> <p>Formula për vlerësimin e progresit në bazë të këtij treguesi është si në vijim:</p>

	$\frac{\text{Trajnimi për hartimin e politikave}}{\text{Numri i stafit të trajnuar mbi hartimin e politikave}} \times 100 = \frac{\text{Trajnimi për hartimin e politikave}}{\text{Numri i stafit të trajnuar mbi hartimin e politikave}} \times 100$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	25% e personelit relevant të QQ dhe ministrive të linjës është trajnuar	75% e personelit relevant të QQ dhe ministrive të linjës është trajnuar;

TREGUESI 1.2.2: RITJA E KAPACITETEVE TË TRAJNIMIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT

Titulli i Treguesit	1.2.2 Rritja e kapaciteteve të trajnimit për Vlerësimin e Ndikimit		
Nën-objektivi përkatës	1.2. Vendorsja e Vlerësimit të Ndikimit		
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi synon të masë nivelin e rritjes së kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe ministror mbi hartimin e politikave/vlerësimin e ndikimit, përmes krijimit të një grupi të trajnerëve që do të zhvillojnë trajnime mbi hartimin e politikave/vlerësimin e ndikimit për stafin përkatës.		
Burimi i të dhënave për monitorimit e treguesit të performancës	Raportet e trajnimit		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë (përgjegjës kryesor) me mbështetje të ofruar nga Zyra Ligjore e ZKM-së dhe IKAP		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Të dhënat që duhet të ofrohen për këtë tregues janë informacionet mbi grupin e trajnerëve që janë certifikuar për ofrimin e trajnimeve mbi /vlerësimin e ndikimit.		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Numri i trajnerëve që janë certifikuar për të ofruar trajnime për hartimin e politikave/vlerësimin e ndikimit duhet të deklarohet.		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	10	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	10	25

TREGUESI 1.2.3: PËRGATITJA DHE MIRATIMI I RRP PËR ZËVENDËSIMIN E KONCEPT DOKUMENTEVE ME VLERËSIM TË NDIKIMIT

Titulli i Treguesit	1.2.3 Përgatitja dhe miratimi i RRP për zëvendësimin e koncept dokumenteve me vlerësim të ndikimit		
Nën-objektivi përkatës	1.2. Vendosija e Vlerësimit të Ndikimit		
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi matë punën përgatitore të nevojshme për të futur vlerësimin e ndikimit si metodologji për analizën “ex ante” të politikave		
Burimi i të dhënave për monitorimit e treguesit të performancës	Rregullorja e Punës së Qeverisë		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Dispozitat në kuadër të RRP-së që vendosin sistemin e VN-së		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi vlerësohet me Po ose Jo në mënyrë që të arrihet objektivi për 2021.</p> <p>Po – Nëse Rregullorja e Punës së Qeverisë ndryshohet dhe nëse ndryshimet përmbajnë bazë të mjaftueshme për futjen e sistemit të VN në procesin për zhvillimin e politikave.</p> <p>Jo – Nëse Rregullorja e Punës nuk ndryshohet apo RRP e re nuk ofron bazë të mjaftueshme për zbatimin e VN në procesin për zhvillimin e politikave.</p>		
Informatat mbi vlerat bazë	Vitit	2016	
	Vlera bazë	Sistemi për zhvillimin e Koncept Dokumenteve në vend të VN-së	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Ministritë e linjës janë të detyruara të hartojnë koncept dokumentet në bazë të Udhëzimeve të përditësuara për Hartimin e Koncept Dokumenteve	VN përfshihet në RRP dhe VN-të prodhohen nga ministritë e linjës

TREGUESI 1.2.4: ZHVILLIMI I POLITIKAVE DO TË BAZOHET MË SHUMË NË DËSHMI DHE VN DO TË PËRDORET RREGULLISHT NGA MINISTRITË E LINJËS

Titulli i Treguesit	1.2.4 Hartimi i politikave do të bazohet më shumë në dëshmi dhe VN do të përdoret rregullisht nga ministrinë e linjës		
Nën-objektivi përkatës	1.2. Vendorsja e Vlerësimit të Ndikimit		
Përshkrimi i Treguesit	Ky tregues matë se si përcaktohen parakushtet për të siguruar politikë-bërjen e bazuar në dëshmi dhe vlerëson nivelin e cilësisë së analizave në propozimet e politikave		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Vlerësimi SIGMA për Kosovën		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	SIGMA (paraqitet në mënyrë të pavarur nga Qeveria e Kosovës)		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Dy herë në vit		
Të dhënat e nevojshme	Shih treguesin përkatës të SIGMA		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues do të matet duke aplikuar metodologjinë e njëjtë që është aplikuar nga SIGMA në treguesin "Shkalla në të cilën procesi i zhvillimit të politikave i shfrytëzon më së miri mjetet analitike." Metodologjia e matjes është në dispozicion në www.sigmaweb.org .		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Vlera 3 në treguesin SIGMA "Shkalla në të cilën procesi i hartimit të politikave shfrytëzon në mënyrën më të mirë mjetet analitike"	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Vlera 3	Vlera 4

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3: TË DHËNAT/STATISTIKAT E PËRMIRËSUARA

TREGUESI 1.3.1: TË DHËNA TË STANDARDIZUARA JANË NË DISPOZICION PËR LLOGARITJET E MKS

Titulli i Treguesit	1.3.1 Të dhënat e standardizuara për llogaritjet e MKS janë ne dispozicion		
Nën-objektivi përkatës	1.3. Të dhënat/statistikat e përmirësuara		
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi matë nëse të dhënat e standardizuara të nevojshme për zbatimin e MKS janë në dispozicion në mënyrë që MKS të mund të zbatohet nga të gjitha ministritë e linjës dhe të përdoret gjatë zhvillimit të politikave.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Dokumenti që përcakton të dhënat e Standardizuara për MKS		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Të dhënat e standardizuara për pagat dhe statistikën e kompanisë të nevojshme për zbatimin e MKS në “Manualin e MKS për Kosovën”		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi vlerësohet me “po” nëse të dhënat e standardizuara të MKS janë plotësisht në dispozicion apo “jo” nëse të dhënat e standardizuara të MKS nuk janë përcaktuar akoma		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ekzistojnë të dhëna të standardizuara MKS	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Të dhënat e standardizuara të MKS janë plotësisht në dispozicion	Të dhënat e standardizuara të MKS janë plotësisht në dispozicion

TREGUESI 1.3.2: BAZA E TË DHËNAVE TË VN-SË ËSHTË ZHVILLUAR

Titulli i Treguesit	1.3.2 Baza e të dhënave të VN-së është zhvilluar
Nën-objektivi përkatës	1.3. Të dhënat/statistikat e përmirësuara
Përshkrimi i Treguesit	Treguesi matë nëse është krijuar baza e të dhënave për vlerësimin e ndikimit që duhet të përdoret nga ministritë e linjës gjatë zhvillimit të politikave (të dhënat do të reflektohen në analizë) dhe nëse bazohet në një përmbledhje të statistikave dhe informacioneve të nevojshme për realizimin më të mirë të vlerësimit të ndikimit.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti për krijimin e bazës së të dhënave si pjesë e monitorimit të SRRM. Vetë baza e të dhënave e VN.
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Sekretariati Koordinues i Qeverisë
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Të dhënat e nevojshme	Raporti mbi organizimin e bazës së të dhënave
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Ekzistojnë dy hapa për matjen e këtij treguesi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në hapin e parë, ZL dhe SKQ vendosin për krijimin e bazës së të dhënave të VN pas zhvillimit, instalimit dhe vendosjes në përdorim të sistemit elektronik (kjo përfshinë strukturën, dizajnin, përmbajtjen e tij) në ZKM dhe të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera relevante. Dizajni i kësaj baze të të dhënave duhet të përcaktohet deri në vitin 2018 nëpërmjet një skice. - Hapi i dytë përfshinë vlerësimin nga SKQ dhe ZL të shkallës në të cilën përdoret baza e të dhënave. Ky është caku që duhet të arrihet deri në vitin 2021. <p>Niveli i përdorimit të bazës së të dhënave do të vlerësohet duke llogaritur</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Numrin e përgjithshëm të VN të aprovuara nga Qeveria gjatë vitit raportues. 2. Numri i VN që tregon se cilat informacione janë përdorur për bazën e të dhënave dhe/ose cilat informacione duhet të shtohen.

	<p>Baza e të dhënave të shfrytëzuara</p> $\% = \frac{\text{Nr.i VN të miratuar}}{\text{Nr i VN që tregon infomacionet që përdoren nga VN dhe boshllëku i informacioneve}} \times 100 \frac{\text{Nr.i VN të miratuar}}{\text{Nr i VN që tregon infomacionet që përdoren nga}}$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ekziston asnjë bazë e të dhënave të VN-së	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Skica për bazën e të dhënave të VN është e gatshme	Baza e të dhënave të VN ekziston dhe përdoret; 80% e gjithë vlerësimeve të ndikimit tregojnë se cilat informacione nga baza e të dhënave janë përdorur dhe cilat informacione duhet të shtohen

OBJEKTIVI SPECIFIK 1.4: VLERËSIMI

TREGUESI 1.4.1: VLERËSIMET REALIZOHEN NË BAZA VJETORE

Titulli i treguesit	Vlerësimet realizohen në baza vjetore		
Nën-objektivi përkatës	1.4. Vlerësimi		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat performancën e Qeverisë në kryerjen e vlerësimeve për legjislacion siç parashihet në bazë të Udhërrëfyesit për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit dhe vlerësimeve të politikave dhe dokumenteve strategjike për të cilat ende nuk është zhvilluar korniza për vlerësim.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Vlerësimet e kryera		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra Ligjore e ZKM-së		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	1. Numri i vlerësimeve të planifikuara për t'u kryer gjatë vitit të raportuar 2. Numri i vlerësimeve të kryera gjatë vitit të raportuar		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi matet duke krahasuar numrin e vlerësimeve që duhet të realizohen çdo vit me numrin e vlerësimeve që planifikohen në kuadër të Strategjisë për Rregullim më të Mirë. Strategjia për Rregullim më të Mirë parasheh përfundimin e: <ul style="list-style-type: none"> • Të paktën 3 vlerësimeve në 2017 • Të paktën 5 vlerësimeve në 2018 • Të paktën 5 vlerësimeve në 2019 • Të paktën 7 vlerësimeve në 2020 • Të paktën 7 vlerësimeve në 2021 		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Asnjë vlerësim i përfunduar dhe i miratuar	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	8 vlerësime (duke shtuar numrat e vitit 2017 dhe 2018)	19 vlerësime (duke shtuar numrat e vitit 2019, 2020 dhe 2021)

TREGUESI 1.4.2: KAPACITETE TË NGRITURA TË TRAJNIMIT MBI VLERËSIMIN

Titulli i treguesit	1.4.2 Kapacitete të rritura të trajnimit mbi vlerësimin		
Nën-objektivi përkatës	1.4 Vlerësimi		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi synon matjen e nivelit të ngritjes së kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe ministror mbi vlerësimin përmes krijimit të një grupi të trajnerëve që do të mbajnë trajnimet mbi vlerësimin për personelin përkatës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet e trajnimeve		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra Ligjore e ZKM-së dhe IKAP		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Të dhënat që duhet të sigurohen për këtë tregues janë informatat për grupin e trajnerëve që janë certifikuar për të ofruar trajnime mbi vlerësimin.		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Duhet të ceket numri i trajnerëve që janë certifikuar për të ofruar trajnime mbi vlerësimin.		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	5 ²	10

² Synimet nuk janë përcaktuar në SRRM, ku vetëm është bërë referencë për organizimin e një TT. Numrat e synuar prej '5' dhe '10' janë përzgjedhur bazuar në supozimin se çdo TT do të ofrojë të paktën pesë persona që do të certifikohen si trajnerë.

TREGUESI 1.4.3: NGRITJA E KAPACITETEVE PËR VLERËSIM NË INSTITUCIONET QQ DHE MINISTRITË E LINJËS

Titulli i treguesit	1.4.3 Ngritja e kapaciteteve për Vlerësim në institucionet QQ dhe ministrinë e linjës		
Nën-objektivi përkatës	1.4 Vlerësimi		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi synon të mat nivelin e ngritjes së kapaciteteve për Vlerësim në Zyrën e Kryeministrit, Qeveri dhe ministrinë e linjës, kryesisht përmes trajnimeve të personelit përkatës të zhvillimit të politikave.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	1) Listat e vijueshmërisë për trajnimet mbi vlerësimin 2) Raportet e trajnimeve		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra Ligjore		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	1. Numri i personelit të trajnuar për Vlerësim në ZKM dhe ministrinë e linjës 2. Numri i personelit relevant që do të trajnohet për Vlerësim në ZKM dhe ministrinë e linjës		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke llogaritur numrin e personelit të trajnuar për Vlerësim në raport me numrin e përgjithshëm të personelit të ZKM-së dhe ministrive të linjës, i cili duhet të të trajnohet për Vlerësim.</p> <p>Të gjitha divizionet ministrore që zhvillojnë politika dhe legjislacion janë relevante, siç janë departamentet/divizionet që plotësojnë një koordinim të funksionit të shqyrtimit të cilësisë. Duhet të trajnohet një anëtar i stafit për secilin prej këtyre departamenteve dhe divizioneve. Numrat e stafit për të cilët trajnimi mbi vlerësimin është relevant janë paraqitur në Shtojcën mbi numrat e trajnimit, të bashkëngjitur me këtë Pasaportë të Treguesve.</p> <p>Numri i përgjithshëm i stafit përkatës që duhet të trajnohet në zhvillimin e politikave është 262 zyrtarë.</p> <p>Formula për vlerësimin e progresit për këtë tregues është si në vijim:</p> $\% \frac{\text{Numri i stafit të trajnuar mbi vlerësimin në ZKM dhe ministrinë e linjës}}{\text{Numri i stafit përkatës për t'u trajnuar mbi vlerësimin në ZKM dhe ministrinë e linjës}} \times 100 = \frac{\text{Numri i stafit të trajnuar mbi vlerësimin në}}{\text{Numri i stafit përkatës për t'u trajnuar mbi vlerësimin në}}$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Trajnimi i personelit përkatës për vlerësimin e legjislacionit ka filluar; të	Kapacitetet për vlerësim legjislativ janë zhvilluar (75% e stafit përkatës në

		paktën 10% e stafit përkatës në çdo ministri të linjës dhe çdo institucion përkatës të QQ-së është trajnuar)	ministritë e linjës dhe institucionet e QQ-së të trajnuar deri në vitin 2021) - 40% e stafit përkatës në institucionet e QQ-së dhe ministritë e linjës të trajnuar mbi vlerësimin e strategjive dhe politikave ³
--	--	--	--

³ Ky është një synim për të cilin do të punohet gjatë zbatimit të Strategjisë për Rregullim më të Mirë. Fillimisht duhet të rregullohet qasja në vlerësimin e strategjive dhe politikave. Pasi ky objektivi është cekur në strategji, ai paraqitet gjithashtu edhe këtu. Kjo pasaportë e treguesve do të përditësohet në të ardhmen për të reflektuar mbi këtë çështje në mënyrë më të detajuar.

TREGUESI 1.4.4: KRIJIMI I PROCESIT PËR PËRDORIMIN E GJETJEVE TË VLERËSIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E LEGJISLACIONIN EKZISTUES

Titulli i treguesit	1.4.4 Krijimi i procesit për përdorimin e gjetjeve të vlerësimit për përmirësimin e legjislacionin ekzistues
Nën-objektivi përkatës	1.4. Vlerësimi
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nëse sistemi për të përdorur vlerësimet e kryera në legjislacionin e ri të hartuar është krijuar. Krijimi i sistemit nënkupton që kërkesat për përdorimin e vlerësimit janë të përfshira në RRP-në e re të Qeverisë dhe të gjitha vlerësimet janë publikuar me një shpjegim sa i përket hapave të mëtutjeshëm që do të ndërmerren. Këto hapa të mëtutjeshëm zbatohen gjithashtu.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Rregullorja e Punës, vlerësimet që janë kryer.
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra Ligjore e ZKM-së
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Të dhënat e nevojshme	<ul style="list-style-type: none"> • Lista e vlerësimeve të identifikuara për t'u kryer çdo vit, të përfshira në PVPQ • Informatat në lidhje me personelin relevant të trajnuar në kuadër të ZKM-së dhe ministrive të linjës në vlerësimin e legjislacionit. "Përkatës" në kuadër të këtij treguesi nënkupton personat e përfshirë në kryerjen e Vlerësimeve: Departamentet Ligjore, Departamentet për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave dhe anëtarët e Grupeve Punuese për Vlerësim në ministritë që kryejnë Vlerësime. • Vlerësimet e kryera • Vlerësimet e publikuara • Rregullorja e re e Punës me dispozitat që lidhen me vlerësimet

Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi matet duke shënuar me 10 ose 20% secilin element që është kryer. 0% shkruhet për çdo element që nuk është përmbushur fare.													
	<table border="1"> <tr> <td>1. Lista e Vlerësimeve të identifikuara që do të kryhet çdo vit e përfshirë si pjesë e PVPQ</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>2. Vlerësimet janë kryer</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>3. Vlerësimet e përfunduara janë publikuar</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>4. Udhëzuesit e vlerësimit reflektojnë të gjitha kërkesat për vlerësimin</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>5. Rregullorja e re e Punës me dispozitat që lidhen me kryerjen e vlerësimeve</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>6. Gjetjet e vlerësimit përdoren për përmirësimin e legjislacionit dhe/ose zbatimin e tij.</td> <td>20%</td> </tr> </table>		1. Lista e Vlerësimeve të identifikuara që do të kryhet çdo vit e përfshirë si pjesë e PVPQ	10%	2. Vlerësimet janë kryer	20%	3. Vlerësimet e përfunduara janë publikuar	20%	4. Udhëzuesit e vlerësimit reflektojnë të gjitha kërkesat për vlerësimin	10%	5. Rregullorja e re e Punës me dispozitat që lidhen me kryerjen e vlerësimeve	20%	6. Gjetjet e vlerësimit përdoren për përmirësimin e legjislacionit dhe/ose zbatimin e tij.	20%
1. Lista e Vlerësimeve të identifikuara që do të kryhet çdo vit e përfshirë si pjesë e PVPQ	10%													
2. Vlerësimet janë kryer	20%													
3. Vlerësimet e përfunduara janë publikuar	20%													
4. Udhëzuesit e vlerësimit reflektojnë të gjitha kërkesat për vlerësimin	10%													
5. Rregullorja e re e Punës me dispozitat që lidhen me kryerjen e vlerësimeve	20%													
6. Gjetjet e vlerësimit përdoren për përmirësimin e legjislacionit dhe/ose zbatimin e tij.	20%													
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016												
	Vlera bazë	0% Vlerësimet nuk janë përdorur në mënyrë sistematike në hartimin e politikave												
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021											
	Vlera e treguesit	40%	100%											

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 2: KOMUNIKIMI EFIKAS PUBLIK, KONSULTIMI PUBLIK DHE PJESËMARRJA E PALËVE TË INTERESIT

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1: PËRMIRËSIMI I KOMUNIKIMIT TË POLITIKAVE

TREGUESI 2.1.1: HARTIMI I PLANIT TË VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E KOMUNIKIMIT TË POLITIKAVE

Titulli i treguesit	2.1.1 Hartimi i Planit të Veprimit për përmirësimin e komunikimit të politikave		
Nën-objektivi përkatës	2.1. Komunikim i përmirësuar i politikave		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat punën e qeverisë për përmirësimin e komunikimit të politikave. Ai do të masë nëse plani i zbatimit për përmirësimin e komunikimit të politikave është hartuar bazuar në analizën e paraqitur në Koncept Dokument.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Plani i Veprimit për komunikimin e politikave		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra për Komunikim me Publikun/ZKM		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	1. Plani i Veprimit për komunikimin e politikave		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi mat nëse është hartuar Plani i Veprimit për komunikimin e politikave		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ka Plan të Veprimit për përmirësimin e komunikimit të politikave	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Zhvillimi i Planit të Veprimit për komunikimin e politikave	I pandryshuar në krahasim me objektivin e 2018

TREGUESI 2.1.2: NGRITJA E KAPACITETEVE TË TRAJNIMIT PËR KOMUNIKIM TË POLITIKAVE

Titulli i treguesit	2.1.2 Ngritja e kapaciteteve të trajnimit për komunikim të politikave		
Nën-objektivi përkatës	2.1 Komunikim i përmirësuar i politikave		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi synon matjen e nivelit të rritjes së kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe ministror për komunikimin e politikave, duke krijuar një grup të trajnerëve që do të ofrojnë trajnime mbi komunikimin e politikave për personelin përkatës.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raportet e trajnimeve.		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra për Komunikim me Publikun në kuadër të ZKM-së (përgjegjëse kryesore) me mbështetjen e IKAP		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Të dhënat që duhet të ofrohen për këtë tregues janë informatat për grupin e trajnerëve që janë certifikuar për të ofruar trajnime për Komunikim të Politikave.		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Duhet të ceket numri i trajnerëve që janë certifikuar për të ofruar trajnime mbi komunikimin e politikave.		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	5	I pandryshuar në krahasim me objektivin e vitit 2018

TREGUESI 2.1.3: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR KOMUNIKIM TË POLITIKAVE

Titulli i treguesit	2.1.3 Zhvillimi i kapaciteteve për komunikim të politikave		
Nën-objektivi përkatës	2.1. Komunikimi i përmirësuar i politikave		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat punën për zhvillimin e kapaciteteve rreth komunikimit të politikave në Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë e linjës, kryesisht nëpërmjet trajnimit të personelit përkatës që është përgjegjës për kryerjen e komunikimit të politikave në qeveri.		

Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	1) Lista e vijimit për trajnimet e komunikimit të politikave 2) Raportet e trajnimit		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra për Komunikim Publik (përgjegjës kryesor) me mbështetjen e IKAP		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	1. Numri i personelit të trajnuar në komunikim të politikave në ZKM dhe ministritë e linjës 2. Numri i personelit përkatës që do të trajnohet për komunikimin e politikave në ZKM dhe ministritë e linjës		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke llogaritur numrin e personelit që është trajnuar në komunikim të politikave të vendosur kundrejt numrit të përgjithshëm të personelit të ZKM-së dhe ministrisë së linjës që identifikohet si relevant për t'u trajnuar në komunikimin e politikave.</p> <p>Të gjitha divizionet ministrore që zhvillojnë politikat dhe legjislacionin janë të rëndësishme, siç janë edhe departamentet/divizionet që përmbushin funksionin e kontrollimit të cilësisë. Është e nevojshme që për secilin nga këto departamente dhe divizione të trajnohet një anëtar i personelit. Numri i personelit për të cilin trajnimi për komunikim të politikave është i rëndësishëm është paraqitur në shtojcën mbi numrat e trajnimit bashkangjitur me pasaportën e treguesve.</p> <p>Numri i përgjithshëm i stafit relevant që duhet trajnuar në komunikimin të politikave është 303 zyrtarë.</p> <p>Formula për vlerësimin e progresit bazë të këtij treguesi është si më poshtë:</p> <p>Trajnimi në komunikim % = $\frac{\text{numri i personelit të trajnuar për komunikimin e politikave gjatë vitit}}{\text{numri i personelit përkatës që duhet trajnuar për komunikimin e politikave}} \times 100$</p> <p>Trajnimi në komunikim % = $\frac{\text{numri i personelit të trajnuar për komunikimin e politikave gjatë vitit}}{\text{numri i personelit përkatës që duhet trajnuar për komunikimin e politikave}} \times 100$</p>		
Informatat mbi vlerën bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Stafi i pa trajnuar	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	50% e personelit relevant të komunikimit në QQ dhe ministritë e linjës të trajnuar	75% e personelit të zhvillimit të politikave në QQ dhe ministritë e linjës të trajnuar

TREGUESI 2.1.4: KOMUNIKIMI I POLITIKAVE I INTEGRUAR NË ZHVILLIMIN E POLITIKAVE

Titulli i treguesit	2.1.4 Komunikimi i politikave i integruar në zhvillimin e politikave		
Nën-objektivi përkatës	2.1. Përmirësimi i komunikimit të politikave		
Përshkrimi i treguesit	Ky tregues e matë nivelin e integritit të aktiviteteve komunikuese në planet zbatuese të Koncept Dokumenteve të miratuara nga Qeveria brenda një viti të caktuar.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Koncept Dokumentet e miratuara në një vit të caktuar		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra e komunikimit publik		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Të dhënat e nevojshme	Planet zbatuese për Koncept Dokumentet e miratuara brenda një viti të caktuar		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke vlerësuar numrin e Koncept Dokumenteve që janë miratuar brenda një viti të caktuar të cilat kanë të integruar aktivitetet komunikuese në planin zbatues. Më pas ky numër pjesëtohet më numrin e përgjithshëm të Koncept Dokumenteve të miratuara gjatë po atij viti dhe shëndërrohet në përqindje.</p> <p>Për vitin 2018, numri i Koncept Dokumenteve që përdoret për llogaritjet është numri i koncept dokumenteve që janë zhvilluar sipas Udhëzuesit dhe Manualit të ri për Hartimin e Koncept Dokumenteve në përputhje me vendimit për t'u dhënë ministrive mundësinë që të përfundojnë KD të cilat kanë filluar të zhvillohen sipas udhëzimeve të mëparshme. Në vitet vijuese, për llogaritje do të përdoren të gjitha KD e miratuara.</p> <p><i>KD Kom. Pol. % = Numri i KD me referencë të qartë të aktiviteteve për komunikim numri i KD të miratuara nga Qeveria x 100</i></p>		
Informatat mbi vlerën bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Komunikimi i politikave që nuk është pjesë e Koncept Dokumenteve apo Planeve për zbatuim	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	15% e Koncept Dokumenteve të miratuara përmbajnë referencë të	100% e koncept dokumenteve të miratuara përmbajnë

		qartë për aktivitetet e komunikimit	përmbajnë referencë të qartë për aktivitetet e komunikimit
--	--	-------------------------------------	--

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2: PËRMIRËSIMI I KONSULTIMIT

TREGUESI 2.2.1: NGRITJA E KAPACITETEVE TË PERSONELIT PËR KONSULTIME

Titulli i treguesit	2.2.1 NGRITJA E KAPACITETEVE TË PERSONELIT PËR KONSULTIME
Nën-objektivi përkatës	2.2. Konsultimi i përmirësuar
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat punën për zhvillimin e kapaciteteve në konsultimin publik në Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë e linjës, kryesisht nëpërmjet trajnimit të stafit përkatës që është përgjegjës për kryerjen e konsultimit publik.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	1) Lista e vijimit për trajnimet e komunikimit të politikave 2) Raportet e trajnimit
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	Zyra për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit; IKAP
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Të dhënat e nevojshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i personelit të trajnuar në vit për konsultimet publike 2. Numri i personelit që janë identifikuar si relevant për tu trajnuar për konsultime publike në Qeveri dhe Ministritë e Linjës 3. Divizioni/departamenti tek i cili individi i trajnuar është duke punuar
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke e llogaritur numrin e personelit të trajnuar për konsultime publike të vendosur kundrejt numrit të përgjithshëm të personelit të ZKM-së dhe ministrive të linjës të identifikuar si relevant për tu trajnuar për konsultimet publike.</p> <p>Të gjitha divizionet ministrore që hartojnë politikat dhe legjislacionin janë të rëndësishme, siç janë edhe departamentet/divizionet që përmbushin funksionin e koordinimit të kontrollit të cilësisë. Është e nevojshme që për secilin nga këto departamente dhe divizione të trajnohet një anëtar i personelit. Numri i stafit për të cilin është i rëndësishëm trajnimi i komunikimit të politikave është paraqitur në shtojcën mbi numrat e trajnimit bashkangjitur me pasaportën e treguesve.</p> <p>Numri i përgjithshëm i stafit përkatës që duhet trajnuar në konsultimin publik është 303 zyrtarë.</p> <p>Formula për vlerësimin e progresit bazuar në këtë tregues është si më poshtë:</p>

	<p>Trajnimi i konsultimit % =</p> $\frac{\text{numri i stafit të trajnuar për komunikimin e politikave gjatë vitit}}{\text{numri i stafit përkatës që duhet trajnuar për komunikimin e politikave}} \times 100$ <p>Trajnimi i konsultimit % =</p> $\frac{\text{numri i stafit të trajnuar për komunikimin e politikave gjatë vitit}}{\text{numri i stafit përkatës që duhet trajnuar për komunikimin e politikave}} \times 100$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	48 stafi i trajnuar	
Informacioni mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Të paktën 10% nga anëtarët relevant të personelit nga çdo ministri e linjës dhe i gjithë personeli relevant i QQ-së janë trajnuar për konsultime	Të paktën 75% nga anëtarët përkatës të personelit nga çdo ministri e linjës janë trajnuar për konsultime

TREGUESI 2.2.2: NIVELI I PËRPUTHJES ME STANDARDET MINIMALE PËR TË GJITHA VENDIMET RELEVANTE TË QEVERISË

Titulli i treguesit	Niveli i përputhjes me standardet minimale për të gjitha vendimet relevante të qeverisë
Nën-objektivi përkatës	2.2. Përmirësimi i konsultimeve
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nivelin e zbatimit të dispozitave të Rregullores Nr. 05/2016 për standardet minimale të konsultimit publik për vendimet më të rëndësishme të marra nga qeveria.
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	1) Raportet mbi konsultimet e mbajtura 2) Raportet mbi strategjitë, koncept dokumentet dhe ligjet primare të miratuara nga qeveria
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	ZQM (përgjegjësi kryesor dhe përgjegjëse për raportimin mbi zbatimin e Standardeve Minimale për Konsultim) SKQ për Koncept Dokumentet ZPS mbi strategjitë ZL të ligjeve primare
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit
Të dhënat e nevojshme	Përmbledhje e ligjeve primare të miratuara Ligjet parësore të paraqitura për konsultim publik Përmbledhje e Koncept Dokumenteve të miratuara Koncept Dokumentet e dorëzuara për konsultim publik Përmbledhje e strategjive të miratuara Strategjitë e dorëzuara për konsultim publik
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Për këtë tregues, vendimet relevante qeveritare përfshijnë vendimet e mëposhtme: miratimin e strategjive, miratimin e Koncept Dokumenteve dhe miratimin e ligjeve primare. Strategjia për rregullim më të mirë ka vendosur objektivin prej 100% për vitin 2019. Sidoqoftë, nuk ka objektiva të ndërmjetme të caktuara për vitin 2017 dhe 2018. Kjo pasaportë mbulon këtë lëshim dhe vendos objektivin e ndërmjetëm për vitin 2018 në 50%. Objektivi për 2021 është i barabartë me objektivat e synuar për vitin 2019. Strategjitë, Koncept Dokumentet dhe ligjet primare për të cilat qeveria- në përputhje me kornizën rregullative dhe rregulloren e punës së qeverisë - vendos që konsultimi publik nuk do të realizohet, janë të përjashtuara nga llogaritja e përqindjeve. Raporti është llogaritur duke krahasuar propozimet relevante që janë dorëzuar për konsultim publik kundrejt numrit të përgjithshëm të propozimeve relevante që duhet dorëzuar për konsultim publik.

	<p>Me qëllim të përmbushjes të kërkesës së konsultimit, projektligji konsiderohet i konsultuar plotësisht me publikun kur koncept dokumenti që është bërë për këtë ligj të propozuar është dorëzuar për konsultim publik.</p> <p>Formula për konsultim % =</p> $\frac{\text{Numri i propozimeve relevante që janë dorëzuar për konsultim publik}}{\text{Numri total i propozimeve të përgjithshme që janë të nevojshme për t'u dorëzuar për konsultim publik}} \times 100 =$ $\frac{\text{Numri i propozimeve relevante që janë dorëzuar për konsultim publik}}{\text{Numri total i propozimeve të përgjithshme që janë të nevojshme për t'u dorëzuar për konsultim publik}} \times 100$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0%	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	50%	100%

TREGUESI 2.2.3: RITJA E EFEKTIVITETIT TË KONSULTIMIT PUBLIK NË HARTIMIN E POLITIKAVE DHE LEGJISLACIONIT

Titulli i treguesit	Rritja e efektivitetit të konsultimit publik në hartimin e politikave dhe legjislacionit (treguesi i SIGMA)		
Nën-objektivi përkatës	2.2. Përmirësimi i konsultimit		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat nivelin e zbatimit të dispozitave të Rregullores nr. 05/2016 për standardet minimale të procesit të konsultimit publik nga ana e qeverisë gjatë hartimit të dokumenteve publike të cilat janë specifikuar në nenin 5.2 të Rregullores.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Treguesi SIGMA: Efektiviteti i konsultimit publik në hartimin e politikave dhe legjislacionit		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	SIGMA		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Dy herë në vit		
Të dhënat e nevojshme	Vlerësimi SIGMA		
Përshkrimi i shkurtët i metodologjisë	Metodologjia e matjes do të gjendet në www.sigmaweb.org .		
Informata mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	3 (SIGMA)	
Informata mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	4	5

OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3: PËRMIRËSIMI I PLANIFIKIMIT TË PUNËS

TREGUESI 2.3.1: HARTIMI DHE MIRATIMI I KD NË PISHP

Titulli i treguesit	2.3.1 Hartimi dhe miratimi i KD në PISHP		
Nën-objektivi përkatës	2.3. Përmirësimi i planifikimit të punës		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat përmbushjen e angazhimit të qeverisë për hartimin dhe miratimin e Koncept Dokumentit mbi planifikimin indikativ shumëvjeçar të punës		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Vendimi i qeverisë mbi miratimin e Koncept Dokumentit për planifikimin indikativ shumëvjeçar të punës		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	SKQ/ZKM		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
TË dhënat e nevojshme	Miratimi i Koncept Dokumentit mbi Planifikimin Indikativ Shumëvjeçar të Punës		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi mat miratimin ose mos-miratimin e Koncept Dokumentit për PISHP		
Informata mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	0	
Informata mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	Koncept Dokumenti i miratuar	I pandryshuar në krahasim me objektivin e vitit 2018

TREGUESI 2.3.2: ZHVILLIMI I PISHP

Titulli i treguesit	Zhvillimi i PISHP		
Nën-objektivi përkatës	2.3. Përmirësimi i planifikimit të punës		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat hartimin dhe zhvillimin e PISHP nga Qeveria, siç parashihet në SRRM.		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Planifikimi Indikativ Shumëvjeçar i Punës		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	SKQ/ZKM		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	Planifikimi Indikativ Shumëvjeçar i Punës		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	Treguesi mat zhvillimin apo mos-zhvillimin e PISHP		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	Nuk ekziston asnjë PISHP	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	PISHP është duke u hartuar në përputhje me vendimin e miratuar në Koncept Dokumentin për PISHP	PISHP i zhvilluar

TREGUESI 2.3.3: RITJA E CILËSISË SË PLANIFIKIMIT TË PUNËS SË QEVERISË

Titulli i treguesit	2.3.3 Rritja e cilësisë së planifikimit të punës së qeverisë		
Nën-objektivi përkatës	2.3. Planifikim i përmirësuar i punës		
Përshkrimi i treguesit	Treguesi mat shkallën në të cilën planifikimi i punës së qeverisë është përmirësuar, kryesisht duke rritur shkallën e zbatimit të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	<ul style="list-style-type: none"> • Plani Vjetor i Punës së Qeverisë (pikat prioritare) • Raporti Vjetor i Qeverisë • Planifikimi Indikativ Shumëvjeçar i Punës 		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	SKQ		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Çdo vit		
Të dhënat e nevojshme	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i aktiviteteve të planifikuara në tabelën A të PVPQ 2. Numri i aktiviteteve të tabelës A të PVPQ të cilat janë zbatuar 		
Përshkrimi i shkurtër i metodologjisë	<p>Treguesi matet duke llogaritur numrin e aktiviteteve të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë të cilat janë zbatuar në krahasim me aktivitetet e planifikuara në Planin Vjetor të Punës së Qeverisë.</p> $\% \text{ e zbatimit të PVPQ} = \frac{\text{Numri i aktiviteteve prioritare të PVPQ të cilat janë zbatuar}}{\text{Numri i aktiviteteve prioritare të planifikuara të PVPQ}} \times 100 = \frac{\text{Numri i aktiviteteve prioritare të PVPQ të cilat janë zbatuar}}{\text{Numri i aktiviteteve prioritare të planifikuara të PVPQ}} \times 100$		
Informatat mbi vlerat bazë	Viti	2016	
	Vlera bazë	68%	
Informatat mbi vlerat e synuara	Viti	2018	2021
	Vlera e treguesit	75 %	85%